



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201302941/2

Tiranë ___/___/2014

Lënda: *Rekomandojmë rillogaritjen e masës së pensionit të pleqërisë shtetasës L.S.*

Drejtuar : **Drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore**

SHKODËR

Zoti Drejtor,

Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë shtetasja L.S, lidhur me mosrishikimin e masës së pensionit të saj të pleqërisë.

Sipas shpjegimeve të saj, shtetasja L.S është përfituese e pensionit të pleqërisë. Fillimisht ka përfituar pension pleqërie në një masë më të lartë nga sa merr aktualisht.

Pretendimi i saj qëndron në faktin se reduktimi i masës së saj të pensionit është i padrejtë dhe bazuar në vjetërsinë e punës, rreth 20 vjet në Ndërmarrjet Shtetërore si dhe të një shpërblimi të veçantë nga shteti, si veprimtare për çështje kombëtare, masa e pensionit të pleqërisë duhet të jetë më e madhe.

Meqënëse nuk ka qenë dakort me uljen e masës së pensionit, ankuesja ka kërkuar pranë institucionit tuaj rishikimin e saj, por edhe pas interesimit të vazhdueshëm, shtetasës L.S nuk ka marrë asnjë përgjigje zyrtare.

Sa më lart, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: "Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike", si dhe në bazë të nenit 21/b të Ligjit "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ku thuhet se : "Paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive",

REKOMANDOJMË:

Rishikimin e masës së pensionit të pleqërisë shtetases L.S.

Në përputhje me nenin 22 të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet shprehimisht se;

“Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet të shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit”,

Duke besuar në bashkëpunimin Tuaj,

AVOKATI I POPULLIT
Igli TOTOZANI

Me Urdhër dhe me Porosi
ND/KOMISIONER
Frederik PASKALI